



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 15

2003

Mars

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 9009 datë 13.2.2003	Për auditimin e brendshëm në sektorin publik.....	431
Ligj nr. 9010 datë 13.2.2003	Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta.....	438
Vendim i KM datë 173, datë 7.3.2003	Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit.....	450

L I G J
Nr.9009, datë 13.2.2003

PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj përcakton fushën e veprimit, objektivat, parimet, organizimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm do të kenë këtë kuptim:

1. Në “sektorin publik” do të përfshihen: ministrinë dhe institucionet e tjera që janë në varësi të Këshillit të Ministrave ose të ministrive; organet e pushtetit vendor dhe subjektet publike në varësi të tyre për fondet publike; shoqëritë tregtare, me kapital tërësisht shtetëror ose ato ku pjesëmarrja e shtetit në kapitalin e tyre është mbi 50 për qind; bankat e nivelit të dytë, shoqëritë e sigurimeve dhe institucionet financiare, në të cilat pjesëmarrja e shtetit në kapitalin e tyre është mbi 50 për qind.

2. “Auditimi i brendshëm” është veprimtari e pavarur, që jep siguri objektive dhe këshilla për drejtimin, i projektuar për të shtuar vlerën dhe përmirësuar veprimet e subjektit publik. Ai ndihmon subjektin me anë të një mënyre sistematike dhe të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, proceset e kontrollit dhe të qeverisjes.

3. “Auditimi i performancës” është procesi i vlerësimit të objektivave, programeve dhe shkallës së realizimit të tyre, lidhur me dobinë, kursimin dhe frytshmërinë.

a) “Kursimi” është përdorimi me masë dhe me kujdes i burimeve për një veprimtari, duke ruajtur cilësinë e nevojshme.

b) “Dobia” është lidhja ndërmjet rezultatit, në kuptimin e mallrave, shërbimeve ose prodhimeve të tjera (rezultateve) dhe burimeve të përdorura për t’i prodhuar ato.

c) “Frytshmëria” është niveli i realizimit të objektivave dhe marrëdhëniet ndërmjet rezultatit të pritur dhe rezultatit faktik të veprimtarisë.

4. “Kontrolli i brendshëm” është procesi i përcaktimit të politikave, procedurave dhe organizimit të punës, për të ndihmuar dhe siguruar drejtimin që programet e subjektit publik do të arrijnë rezultatet e synuara, duke përdorur burimet në përputhje me qëllimet dhe objektivat e këtij subjekti, që ato të jenë të mbrojtura nga shpenzimet e pajustificuara, keqadministrimet e mashtrimet dhe që për vendimmarrjen të përftohen, të ruhen, të përdoren dhe të raportohen të dhëna të besueshme e bashkëkohore.

5. “Auditët e brendshëm”, që më poshtë do të quhen “auditë”, janë profesionistë të auditimit të brendshëm të sektorit publik, të kualifikuar sipas kërkesave të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 3
Parime të përgjithshme

Auditimi i brendshëm në sektorin publik mbështetet në këto parime: ligjshmërinë, pavarësinë, paanësinë dhe fshehtësinë.

a) Ligjshmëria parakupton që auditimi në sektorin publik mbështetet në ligjin themelor të shtetit, Kushtetutën, legjislacionin në fuqi dhe në marrëveshjet ndërkombëtare, të pranuar e të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

b) pavarësia parakupton planifikimin, përcaktimin, realizimin dhe raportimin e veprimtarisë së auditimit jashtë çdo ndikimi që ka lidhje me veprimtarinë e audituar.

c) paanësia parakupton pasqyrimin objektiv, të paanshëm dhe transparent në dokumentet përkatëse, të të gjitha fakteve dhe rrethanave, që lidhen me veprimtarinë e audituar.

ç) fshehtësia parakupton respektimin e fshehtësisë së të dhënave të marra gjatë auditimit.

Neni 4

Standardet e auditimit

Veprimtaria e auditimit të brendshëm në sektorin publik mbështetet kryesisht në standardet ndërkombëtare të auditimit, si edhe në udhëzimet e nxjerra në zbatim të tyre, të miratuara nga Ministri i Financave me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm, i cili vepron sipas përcaktimeve të bëra në nenin 10 të këtij ligji. Ministri i Financave, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm do të zgjedhë një prej standardeve të këtyre organizmave: Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (ISA), Organizatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC), Organizatës së Institucioneve të Larta të Auditimit (INTOSAI), standardet për praktikat profesionale të auditit të brendshëm, të nxjerra nga Instituti i Auditorëve të Brendshëm (IIA).

Neni 5

Objektivat e auditimit të brendshëm në sektorin publik

Objektivat e auditimit të brendshëm në sektorin publik janë:

1. Dhënia në mënyrë të pavarur e një sigurie të arsyeshme për titullarin e subjektit publik, për të përmirësuar veprimtarinë e subjektit dhe frytshmërinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, duke përdorur sistematikisht mënyrën më të mirë.

2. Shqyrtimi, vlerësimi dhe dhënia e rekomandimeve për sistemet e kontrollit të brendshëm dhe transaksionet lidhur me:

rreziqet e brendshme të kontrollit të drejtimit;

b) përdorimin me kursim, dobi dhe frytshmëri të burimeve financiare dhe njerëzore;

c) shkallën në të cilën rezultatet e programeve të subjektit të audituar plotësojnë objektivat e tij;

ç) pajtueshmërinë e veprimtarisë së subjektit të audituar me legjislacionin në fuqi;

d) kujdesin për plotësimin e të dhënave financiare dhe të drejtimit, si edhe përdorimin e tyre për mbështetjen e vendimmarrjes.

Neni 6

Fusha e auditimit të brendshëm në sektorin publik

Fusha e auditimit të brendshëm në sektorin publik përfshin të gjitha kontrollet e brendshme, financiare dhe të drejtimit, sipas rregullave për auditimin të propozuara nga Ministri i Financave dhe të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Auditimi i brendshëm nuk ka asnjë kufizim në planifikimin dhe kryerjen e veprimtarisë së tij.

Neni 7

Organet e auditimit të brendshëm

Organet e auditimit të brendshëm janë:

Komiteti i Auditimit të Brendshëm.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave.

3. Njësitë e auditimit të brendshëm në ministritë dhe subjektet e tjera publike.

Neni 8

Komiteti i Auditimit të Brendshëm

1. Komiteti i Auditimit të Brendshëm, që më poshtë do të quhet Komiteti, përbëhet nga shtatë anëtarë, të cilët emërohen nga Ministri i Financave, ndër të cilët: tre profesionistë të auditimit të brendshëm, një pedagog nga Fakulteti Ekonomik, një jurist ose kontabilist nga sektori privat, një specialist nga organizma të tjerë profesionalë dhe Drejtori i Përgjithshëm i Auditimit, që është anëtar i përhershëm i këtij Komiteti.

2. Emërimi i anëtarëve të Komitetit bëhet për një periudhë kohe jo më pak se dy vjet dhe jo më shumë se katër vjet. Jashtë përbërjes së Komitetit, Ministri i Financave cakton një sekretar, i cili organizon mbledhjet e Komitetit dhe administron dokumentacionin përkatës.

3. Komiteti, në mbledhjen e vet të parë, zgjedh Kryetarin nga anëtarët e tij dhe kjo zgjedhje bëhet me shumicë të thjeshtë votash. Në rast se Komiteti nuk arrin të zgjedhë Kryetarin, ky i fundit caktohet nga Ministri i Financave. Mandati i Kryetarit të Komitetit zgjat 1 vit me të drejtë rizgjedhjeje.

4. Komiteti ka funksionet e mëposhtme:

a) jep këshilla dhe mbështet Ministrin e Financave dhe Drejtorin e Përgjithshëm në të gjitha aspektet e planeve dhe të punës së auditimit të brendshëm, në praktikat ndërkombëtare të auditimit, në cilësinë dhe funksionimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik;

b) shqyrton raportet tremujore dhe vjetore të auditimit të brendshëm, të paraqitura nga Drejtori i Përgjithshëm, raporte të cilat më pas i paraqiten Ministrit të Financave;

c) kryen detyra të tjera të caktuara nga Ministri i Financave.

5. Komiteti mbledhet në seanca të zakonshme, jo më pak se një herë në tre muaj. Këshilli i Ministrave përcakton rregullat për funksionimin dhe shpërblimin e anëtarëve të Komitetit.

Neni 9

Drejtoria e Përgjithshme dhe njësitë e auditimit

1. Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, që më poshtë do të quhet Drejtoria, përgjigjet para Ministrit të Financave për të gjitha aspektet e funksionimit të auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Drejtoria drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili është nëpunës civil.

Struktura organizative dhe numri i punonjësve të Drejtorisë caktohen me urdhër të Kryeministrit.

2. Niveli i njërive të auditimit të brendshëm (drejtori, zyra ose njësi të tjera) përcaktohet nga Kryeministri për ministritë dhe institucionet qendrore dhe nga këshillat mbikëqyrës për shoqëritë tregtare me pjesëmarrje të kapitalit shtetëror mbi 50 për qind.

Këto struktura, në asnjë rast, nuk mund të jenë në përbërje të strukturave të tjera operative.

Neni 10

Përgjegjësitë dhe detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm

1. Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për:

a) përvijimin e kuadrit për kryerjen e auditimit të brendshëm në sektorin publik;

b) raportimin te Ministri i Financave dhe në Komitetin e Auditimit për politikat, programet, standardet dhe çdo aspekt tjetër auditimi;

c) sigurimin e një procesi me cilësi të auditimit të brendshëm në sektorin publik;

ç) përgatitjen e raportit vjetor për auditimin e brendshëm, i cili, pas shqyrtimit dhe miratimit në Komitetin e Auditimit të Brendshëm, i paraqitet Ministrit të Financave dhe nëpërmjet tij Këshillit të

Ministrave;

d) përgatitjen e raporteve tremujore për Komitetin e Auditimit të Brendshëm;
dh) formulimin dhe zbatimin e programeve të kualifikimit dhe përsosjes profesionale për auditët e brendshëm në sektorin publik;

e) mbikëqyrjen e cilësisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik dhe zbatimin e standardeve, metodikave e rregullave të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

2. Drejtori i Përgjithshëm ka këto detyra:

a) të përpilojë dhe të përsosë standarde për cilësinë e auditimit, të detyrueshme për t'u zbatuar nga auditët e brendshëm në të gjithë sektorin publik;

b) të përcaktojë politika auditimi dhe raportimi dhe, nëpërmjet Ministrit të Financave, t'i propozojë Këshillit të Ministrave nxjerrjen e rregulloreve dhe përcaktimin e procedurave të auditimit;

c) të përcaktojë tematika auditimi për fusha të rëndësishme të veçantë, të identifikuara nga Drejtori i Përgjithshëm, Ministri i Financave ose Këshilli i Ministrave dhe t'ua dërgojë ato për zbatim drejtuesve të njësive të tjera të auditimit të brendshëm;

ç) të përpilojë standarde dhe të përcaktojë politika kualifikimi e rekrutimi për auditët e brendshëm, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike;

d) të kryejë auditimin në subjektet e sektorit publik, kur Ministri i Financave e çmon të arsyeshme që auditimi i brendshëm i këtyre subjekteve nuk është i frytshëm.

Neni 11

Përgjegjësitë e drejtuesve të njësive të auditimit

Drejtuesit e njësive të auditimit janë përgjegjës për:

a) përvijimin e kuadrit të auditimit të brendshëm në subjektin publik;
b) përzgjedhjen e personelit të auditimit mbi bazë konkurrimi, sipas listës së kandidatëve të kualifikuar sipas këtij ligji dhe në përputhje me legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës në subjekt;

c) sigurimin e përdorimit me frytshmëri të burimeve të auditimit dhe kualifikimin e tyre;

ç) zbatimin e rregullave të auditimit të brendshëm, politikave sektoriale, metodologjive, procedurave dhe udhëzimeve të nxjerra për auditimin;

d) përgatitjen e planit vjetor të auditimit dhe paraqitjen e tij për miratim të ministri ose titullari i subjektit publik. Një kopje e miratuar i dërgohet edhe Drejtorit të Përgjithshëm;

dh) organizimin dhe kryerjen e auditimeve të brendshme, me frytshmëri dhe në kohë, të të gjitha subjekteve brenda linjës së ministrisë ose subjektit publik dhe paraqitjen e raporteve të auditimit të ministri ose titullari i subjektit publik dhe të Drejtorit të Përgjithshëm, sipas formës së përcaktuar nga ky i fundit;

e) sigurimin, që të gjitha letrat e punës së auditimit, gjatë procesit të monitorimit dhe të sigurimit të cilësisë, të jenë të përmbledhura sipas udhëzimeve të Drejtorit të Përgjithshëm;

ë) paraqitjen e raporteve përmbledhëse tremujore dhe vjetore të ministri dhe të Drejtorit të Përgjithshëm, sipas formës së përcaktuar nga ky i fundit, mbi rezultatet e auditimeve të brendshme;

f) sigurimin e drejtimit të auditimit të brendshëm, duke përfshirë dhe kualifikimin e auditëve.

Neni 12

Përgjegjësitë e ministrave dhe titullarëve të subjektit publik për auditimin

1. Ministrat dhe titullarët e subjekteve publike janë përgjegjës për:

a) ngritjen e kontroleve të brendshme të besueshme që sigurojnë realizimin e veprimtarisë së subjektit publik, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi dhe realizimin e programeve me kursim, dobi dhe frytshmëri;

b) sigurimin e burimeve njerëzore dhe materiale për realizimin e objektivave të auditimit dhe krijimin e kushteve për funksionimin normal të tij;

c) përzgjedhjen e auditëve të brendshëm të kualifikuar sipas këtij ligji dhe në përputhje me legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës;

ç) zbatimin e rekomandimeve të nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm, drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm dhe nga Komiteti i Auditimit të Brendshëm;

d) ndreqjen e parregullsive të vërejtura nga auditimet e kryera dhe marrjen e masave disiplinore ose administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

dh) kryerjen e detyrave të tjera, të parashikuara në këtë ligj.

2. Ministri i Financave është përgjegjës për:

a) ngritjen dhe zbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në sektorin publik, duke i propozuar Këshillit të Ministrave nxjerrjen e akteve përkatëse për këtë qëllim;

b) miratimin paraprak të politikave, metodologjive, procedurave dhe rregullave të auditimit, të propozuara nga Drejtori i Përgjithshëm dhe paraqitjen e tyre për miratim në Këshillin e Ministrave;

c) emërimin dhe shkarkimin nga detyra të anëtarëve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm;

ç) paraqitjen për diskutim në Këshillin e Ministrave të raportit vjetor për auditimin e brendshëm;

d) detyra të tjera, të parashikuara në këtë ligj.

Neni 13

Kushtet e pranimit për punësimin e auditëve

Punësimi i auditëve bëhet sipas rastit, në përputhje me procedurat e caktuara në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, Kodin e Punës ose me ligje të tjera që rregullojnë marrëdhëniet e punës. Përveç kushteve të përgjithshme, të përcaktuara në këto ligje, punësimi në njësitë e auditimit të brendshëm të sektorit publik kërkon që auditët:

a) të kenë mbaruar studimet universitare në njërin nga degët ekonomi, financë, kontabilitet, drejtësi ose disiplina të tjera, të përcaktuara nga Drejtori i Përgjithshëm, të kenë përvojë pune jo më pak se pesë vjet ose të kenë fituar titullin e ekspertit kontabël dhe të kenë kaluar provimet e kualifikimit para një komisioni shtetëror, ku të jenë titulluar si auditë të brendshëm;

b) të kenë punuar si të tillë në sektorin publik për një periudhë kohe të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave dhe që në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji të jenë të punësuar në njësitë e auditimit me kusht që, brenda një periudhe pesëvjeçare, t’u nënshtrohen provimeve të kualifikimit për t’u rikualifikuar si auditë të brendshëm.

Komisioni shtetëror i kualifikimit të auditëve ngrihet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Financave. Vendimi përcakton edhe rregullat e funksionimit dhe të shpërblimit të anëtarëve të këtij komisioni.

Neni 14

Të drejtat e auditëve

Auditët e brendshëm, për ushtrimin e funksioneve të përcaktuara në këtë ligj, kanë këto të drejta:

a) të auditojnë, në përputhje me kërkesat e standardeve të auditimit dhe me përgjegjësitë e përcaktuara në këtë ligj;

b) të kërkojnë, të marrin dhe të përdorin lirisht dhe pa kufizim të gjitha të dhënat me karakter teknik, ekonomik e financiar dhe të dhënat e drejtimit të subjektit publik që auditohet, duke marrë përsipër ruajtjen e fshehtësisë së tyre, sipas legjislacionit në fuqi;

c) të tërheqin, për nevoja auditimi, kopje të dokumenteve, të vërtetuara ose origjinale, kundrejt vërtetimit të lëshuar. Dokumentet origjinale duhet të kthehen te subjekti publik brenda 72 orëve;

ç) të kërkojnë deklarime nga të audituarit ose nga personat e tjerë, për problemet që lidhen me auditimin, kur është e nevojshme;

d) të hyjnë dhe të verifikojnë në vend, në depo, magazina, njësi ose objekte, pa asnjë kufizim; të verifikojnë dhe të vlerësojnë kudo që të ndodhen vlera materiale e monetare në pronësi të subjektit publik, duke respektuar rregulloren e brendshme të subjektit dhe programin e auditimit;

dh) t'i propozojnë, me shkrim dhe në mënyrë të arsyetuar, drejtuesit të njësisë së auditimit dhe nëpërmjet tij ministrit ose titullarit të subjektit publik, ndalimin e përkohshëm të veprimeve, që bien ndesh me legjislacionin në fuqi ose që cenojnë interesat ekonomike të subjektit, deri në shqyrtimin përfundimtar nga organet përkatëse;

e) t'i japin rekomandime subjektit të audituar për ndreqjen e parregullsive të vërtetuara nga auditimi dhe përmirësimin e sistemeve të kontrollit;

ë) të propozojnë sipas rastit masa me karakter zhdëmtimi ose masa disiplinore, kur vërtetohen shkelje, dëme dhe parregullsi;

f) të marrin të dhëna të dokumentuara nga bankat e nivelit të dytë, sipas kërkesës me shkrim të Drejtorit të Përgjithshëm ose drejtuesit të njësisë së auditimit, kur është e nevojshme për procesin e auditimit, për numrin e llogarive të hapura ose të mbyllura të subjektit publik në auditim dhe transaksionet e subjekteve publike në auditim.

Neni 15

Ndalime dhe përjashtime

1. Auditëve u ndalohet:

- a) të jenë të zgjedhur në të gjitha funksionet drejtuese në strukturat e partive politike;
- b) të kryejnë detyra të tjera operative brenda subjektit, që nuk kanë të bëjnë me funksionin e auditit të brendshëm në sektorin publik;
- c) të ushtrojnë çdo veprimtari ose punë tjetër që sjell të ardhura vetjake, që është në konflikt interesash me ushtrimin e auditimit.

2. Auditëve u lejohet:

- a) të thirren si ekspertë nga gjykata ose prokuroria;
- b) të japin mësim në shkolla ose kurse kualifikimi;
- c) të ushtrojnë veprimtari të tjera kur nuk ndalohet me këtë ligj ose ligje të tjera.

Neni 16

Konflikte interesash

Auditi i brendshëm duhet të njoftojë paraprakisht, me shkrim, Drejtorin e Përgjithshëm ose drejtuesin e njësisë së auditimit të brendshëm për ndonjë konflikt të mundshëm interesash që rrjedh nga pjesëmarrja e tij në auditimin e një subjekti. Me konflikt interesash do të kuptohet:

- a) të qenët i punësuar i auditit gjatë tre vjetëve të fundit në subjektin publik që do të auditohet;
- b) të qenët në funksione drejtuese, gjatë tre vjetëve të fundit në subjektin publik që do të auditohet, të auditit, bashkëshortes/bashkëshortit, të të afërmeve me lidhje gjinie deri në shkallën e tretë, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 364 të Kodit Civil;

c) zotërimi nga auditi, bashkëshortja/bashkëshorti, të afërmit, me lidhje gjinie deri në shkallën e tretë, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 364 të Kodit Civil, i aksioneve ose pjesëve të kapitalit në subjektin publik që do të auditohet.

ç) rrethana të tjera të caktuara që mund të mbartin konflikt interesash, kur gjykohen si të tilla dhe arsyetohen me shkrim nga Drejtori i Përgjithshëm ose drejtuesi i njësisë së auditimit.

Auditët në konflikt interesash nuk duhet të marrin pjesë në auditim. Nëse vërtetohet se në auditim kanë marrë pjesë një ose më shumë auditë që janë në konflikt interesash, siç parashikohet në këtë nen, Drejtori i Përgjithshëm ose drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm duhet të zhvlerësojë auditimin dhe ta përsërisë atë në një kohë të caktuar.

Neni 17

Përgatitja e akteve nënligjore

Këshilli i Ministrave, brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit, nxjerr aktet nënligjore në zbatim të neneve 6, 8, 10, 12 dhe 13 të këtij ligji.

Neni 18
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3741, datë 19.3.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J
Nr.9010, datë 13.2.2003

PËR ADMINISTRIMIN MJEDISOR TË MBETJEVE TË NGURTA

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj synon mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve të ngurta, nëpërmjet administrimit mjedisor të tyre në çdo fazë, përfshi krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin, të cilat çojnë në pakësimin e mbetjeve dhe zvogëlimin e ndikimeve të tyre të rrezikshme e të dëmshme.

Neni 2
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. “Asgjësimi i mbetjes” përfshin proceset pas të cilave nuk parashikohet përpunim tjetër i mbetjes dhe që mbyllen me groposjen e hedhurinës.
2. “Hedhurinë” është pjesa e mbetur pas përpunimit të mbetjes që nuk ka më vlerë përdorimi.
3. “Mbetje bujqësore dhe blegtorale” janë mbetjet e përfuara nga veprimtaritë e fermerëve si: mbetjet masë vegjetative bimore dhe mbetjet që krijohen nga veprimtari jetësore të blegtorisë.
4. “Mbetje e ngurtë” është një lëndë, një objekt ose pjesë e tij, të cilat nuk përdoren më ose që zotëruesi do t'i hedhë. Lëndët, objektet ose pjesët e tyre vlerësohen si mbetje për sa kohë që materialet e nxjerra prej tyre ose energjia e prodhuar nuk përfshihen në procesin e prodhimit.
5. “Mbetje industriale” janë mbetjet e krijuara nga veprimtaritë industriale, artizanale dhe nga shërbimet.
6. “Mbetje spitalore” janë mbetjet e krijuara nga spitale ose shërbime shëndetësore, institucione

shëndetësore kërkimore, ku përfshihen materialet e rrezikshme dhe jo të rrezikshme.

7. “Mbetje të ndërtimit” janë mbetjet si: gurë, dhera, beton, tulla, që mbeten nga veprimtaritë ndërtuese, rindërtuese, meremetuese dhe prishëse të ndërtesave dhe strukturave të tjera.

8. “Mbetje të vëllimshme” janë mbetje me përmasa të mëdha pajisjesh e makinerish, grumbullimi, transportimi dhe largimi i të cilave kryhet me metoda e teknika të veçanta.

9. “Mbetje urbane” janë mbetjet e shtëpive, të ndërtesave administrative, sociale dhe publike. Në këtë emërtim përfshihen edhe mbetjet që vijnë si rezultat i veprimtarive tregtare, vendeve të pushimit e argëtimit, sasisë dhe përbërjet e të cilave nuk pengojnë trajtimin e tyre bashkë me mbetjet urbane.

10. “Përpunimi i mbetjes” është ndryshimi i vetive ose i përbërjes së mbetjes, duke e transformuar atë në produkt përfundimtar ose në lëndë të parë apo ndihmëse për prodhimin e produkteve përfundimtare.

11. “Prodhuesi i mbetjes” është personi fizik dhe juridik, veprimtaria e të cilit krijon mbetje.

12. “Riciklimi i mbetjes” është ripërtëritja ose rinovimi i vetive të mbetjes, për t’u përdorur më pas si lëndë e parë ose si material ndihmës.

13. “Zotëruesi i mbetjes” është personi fizik dhe juridik:

- a) veprimtaria e të cilit krijon këtë mbetje;
- b) i cili grumbullon, ruan përkohësisht, transporton dhe largon për në vendin e caktuar mbetje të ngurta;
- c) i cili përpunon dhe asgjëson mbetje të ngurta.

Zotëruesi i mbetjes është i njohur dhe i identifikuar si subjekt të drejtash e detyrash në çdo fazë të procesit të administrimit të mbetjeve që nga krijimi deri në asgjësimin e tyre.

Neni 3

Objekti

1. I nënshtrohen administrimit, sipas kërkesave të këtij ligji:

- a) mbetjet urbane;
- b) mbetjet industriale;
- c) mbetjet spitalore;
- ç) mbetjet e ndërtimit;
- d) mbetjet në sistemin e kanalizimeve të ujërave të zeza, kanaleve kulluese e rezervuarëve;
- dh) mbetjet bujqësore dhe blegtorale;
- e) mbetjet e vëllimshme.

2. Ky ligj nuk zbatohet për mbetjet e rrezikshme, radioaktive, bërthamore dhe eksplozive, administrimi i të cilave rregullohet me ligje të veçanta.

3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, miraton “Katalogun shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, sipas “Katalogut europian të mbetjeve”.

Neni 4

Zbatimi

Detyrimeve të këtij ligji u nënshtrohen personat fizikë e juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj:

- a) veprimtaritë e të cilëve krijojnë mbetje;
- b) kur janë zotërues të mbetjeve, të angazhuar dhe të licencuar për grumbullimin, depozitimin, transportimin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin e tyre;
- c) organet shtetërore, organizatat shoqërore dhe shtetasit.

Neni 5

Detyrat e organeve shtetërore

1. Ministria e Mjedisit, në bashkëpunim me agjencitë rajonale dhe Inspektoratin e Mjedisit organizojnë punën për funksionimin e procesit të administrimit mjedisor të mbetjeve dhe kontrollojnë zbatimin e tij në të gjitha nivelet.

2. Organet shtetërore, qendrore e vendore, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit kanë për detyrë:

- a) hartimin e planeve kombëtare dhe lokale për administrimin mjedisor të mbetjeve;
- b) përcaktimin e metodologjisë për trajtimin mjedisor të mbetjeve, në përputhje me llojin e natyrën e tyre;
- c) sigurimin dhe përdorimin e efektshëm të mjeteve të nevojshme financiare;
- ç) kontrollin e vazhdueshëm mbi veprimtaritë që krijojnë mbetje, si dhe mbi ato që angazhohen në transportimin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin e tyre në fushat e sektorët që mbulojnë.

Neni 6

Taksa e mbetjeve

Personat fizikë e juridikë, vendas e të huaj, veprimtaritë e të cilëve krijojnë mbetje, paguajnë taksë për krijimin e mbetjeve dhe shkarkimin e tyre në mjedis. Masa dhe lloji i taksës, mënyrat e pagesës, organet që i vjelin, kriteret e përdorimit mjedisor të saj caktohen me ligj.

KREU II

PARANDALIMI I NDOTJES NGA MBETJET E NGURTA

Neni 7

Qëllimi i administrimit të mbetjeve

Procesi i administrimit të mbetjeve synon që:

- a) nga veprimtaritë prodhuese të rezultojnë sa më pak mbetje;
- b) në mbetjet e krijuara, vendin kryesor ta zënë mbetjet e degradueshme, të riciklueshme e të përpunueshme;
- c) administrimi i tyre të jetë cikël sa më i shkurtër, me qëllim që të zvogëlohet koha e ekspozimit të tyre në mjedis;
- ç) mbetjet të grumbullohen dhe të trajtohen të ndara në të gjitha fazat e administrimit të tyre dhe të mos përzihen me mbetjet e rrezikshme dhe inerte. Trajtimi i tyre në një fazë të mëparshme të mos pengojë përdorimin e mëtejshëm të tyre;
- d) të pakësohet sa më shumë lëvizja e transporti i mbetjeve dhe asgjësimi i tyre të kryhet në impiantin më të afërt;
- dh) për hedhurinat që rezultojnë pas përpunimit të mbetjeve, të kryhet groposje e sigurt.

Neni 8

Veprimet e ndaluara

Në territorin e Republikës së Shqipërisë janë të ndaluara:

- a) braktisja, shkarkimi, hedhja në tokë ose në ujërat sipërfaqësore e mbetjeve që çojnë në degradimin e vetive të tokës ose të ujërave sipërfaqësore dhe shkaktjnë rrezik ose dëm për shëndetin dhe mjedisin;
- b) përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve jashtë zonave të përcaktuara nga organet e qeverisjes vendore;
- c) importimi i mbetjeve dhe i hedhurinave, që rezultojnë nga trajtimi i tyre, me qëllim ruajtjeje, depozitimi ose asgjësimi;
- ç) grumbullimi, transportimi, ruajtja, riciklimi, përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve nga personat fizikë e juridikë, të palicencuar për kryerjen e këtyre veprimtarive;

d) përpunimi, depozitimi dhe asgjësimi i mbetjeve me teknika dhe teknologji të papërshtatshme dhe të pamiratuara nga Ministri i Mjedisit dhe ministrat përkatës;

dh) djegia në natyrë, përfshirë edhe vetëdjegien e mbetjeve dhe të hedhurinave që rezultojnë nga trajtimi i tyre.

Neni 9

Detyrime të krijuesit të mbetjeve

1. Personat fizikë dhe juridikë, veprimtaria e të cilëve krijon mbetje, detyrohen:

a) të ndërtojnë linja dhe impiante për riciklimin dhe përpunimin e mbetjeve, në përputhje me teknologjinë, me natyrën dhe sasinë e mbetjeve që krijojnë;

b) t'i ruajnë dhe t'i trajtojnë mbetjet që të mos vështirësojnë proceset pasuese të administrimit mjedisor të tyre;

c) të ndajnë që në burim mbetjet në kosha të veçantë të dallueshëm.

2. Për plotësimin e këtyre detyrimeve, personi fizik ose juridik, veprimtaria e të cilit krijon mbetje, harton programin e masave teknike, teknologjike e organizative të trajtimit të mbetjeve, i cili kontrollohet nga Inspektorati i Mjedisit, nga organi që ka licencuar veprimtarinë, si dhe nga organet e qeverisjes vendore të zonës ku zhvillohet veprimtaria.

Neni 10

Detyrimet e zotëruesit të mbetjeve

1. Zotëruesit e mbetjeve sigurojnë:

a) respektimin e kërkesave të ligjit nr.8094, datë 21.3.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”, të këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tyre;

b) ruajtjen e mbetjeve në kushte të veçanta, sipas tipit, sasisë, origjinës dhe vetive të tyre;

c) ndarjen e mbetjeve të rrezikshme prej mbetjeve të tjera, ruajtjen e sigurt të mbetjeve, për të cilat nuk ekzistojnë mënyra të përshtatshme përpunimi dhe asgjësimi;

ç) mbajtjen e regjistrave të mbetjeve, sipas klasifikimit të tyre, ku hidhen të dhënat për sasinë, përmbajtjen dhe periodicitetin e grumbullimit dhe të transportit, të dhëna për ruajtjen dhe largimin e mbetjeve në vendet e caktuara;

d) grumbullimi i mbetjeve të rrezikshme bëhet i veçuar dhe ato ruhen përkohësisht në mbajtës specialë, paketohen, etiketohen dhe transportohen në përputhje me rregullat dhe standardet ndërkombëtare të miratuara në Republikën e Shqipërisë.

2. Lëvizja e mjeteve nga një zotërues tek tjetri bëhet vetëm mbi bazën e kontratave.

3. Zotëruesit e mbetjeve dëmshpërblejnë dhe rehabilitojnë, me shpenzimet e tyre, dëmet që shkaktojnë në shëndet dhe në mjedis.

4. Shpenzimet për grumbullimin, transportin, ruajtjen, përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve përballohen nga zotëruesit e mbetjeve.

KREU III

TRAJTIMI I MBETJEVE SIPAS LLOJIT

Neni 11

Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve urbane

1. Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve urbane kryhen nëpërmjet metodave dhe renditjes së mëposhtme të detyrueshme për zbatim:

a) ndarja e mbetjeve sipas klasifikimit të miratuar;

b) riciklimi dhe ripërdorimi i tyre;

c) kompostimi;

ç) groposja;

d) djegia në impiante të posaçme.

2. Ministri i Mjedisit dhe Ministri i Shëndetësisë miratojnë rregullore tip për secilën nga metodat e mësipërme. Organet e qeverisjes vendore miratojnë rregulloret për çdo rast konkret, duke iu referuar rregulloreve tip të miratuara.

Neni 12

Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve të ndërtimit

1. Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve të ndërtimit bëhet me ripërdorim dhe groposje.

2. Ministri i Mjedisit dhe Ministri i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit miratojnë rregulloren e trajtimit të mbetjeve të ndërtimit nga krijimi, transportimi e deri tek asgjësimi i tyre.

Neni 13

Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve industriale

1. Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve industriale bëhen nëpërmjet impianteve dhe teknologjive të veçanta, për çdo lloj mbetje industriale.

2. Ministri i Mjedisit dhe Ministri i Industrisë dhe Energjetikës miratojnë rregulloren e trajtimit të mbetjeve industriale, si dhe kriteret e rregullat për instalimin dhe funksionimin e impianteve të përpunimit.

Neni 14

Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve të minierave

1. Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve të shpim-kërkimit dhe shfrytëzimit të pasurive minerare kryhen pa penguar studimin, nxjerrjen dhe cilësitë e tyre, si dhe pa shkaktuar dëme në ujërat sipërfaqësore e nëntokësore, në peizazh e në biodiversitet.

2. Ministri i Mjedisit dhe Ministri i Industrisë dhe Energjetikës miratojnë rregulloren e trajtimit të mbetjeve të minierave që nga krijimi, transporti e deri tek asgjësimi i tyre.

Neni 15

Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve të ushtrisë

1. Mbetjet e krijuara nga repartet, ndërmarrjet e instalimet ushtarake përpunohen dhe asgjësohen prej tyre, në përputhje me kërkesat e rregulloreve përkatëse të ushtrisë.

2. Ministria e Mbrojtjes kontrollon zbatimin e kërkesave të rregulloreve për administrimin dhe asgjësimin e mbetjeve të sektorit ushtarak.

Neni 16

Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve bujqësore dhe blegtorale

1. Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve bujqësore dhe blegtorale kryhen nga vetë fermat që i kanë krijuar, duke përdorur kompostimin, riciklimin dhe teknologji të tjera të veçanta.

2. Ministri i Mjedisit dhe Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit miratojnë rregulloren e trajtimit të mbetjeve bujqësore dhe blegtorale, të detyrueshme për çdo fermer dhe të kontrollueshme nga inspektoratet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe nga organet e qeverisjes vendore.

Neni 17

Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve të vëllimshme

1. Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve të vëllimshme kryhen nga personat fizikë e juridikë, të specializuar dhe të licencuar për këtë veprimtari. Për veprimtari që shtrihen në të gjithë vendin, licencimin e bën Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacioneve. Për veprimtaritë lokale, licencimin e bëjnë organet e qeverisjes vendore.

2. Ministri i Mjedisit dhe Ministri i Transportit dhe Telekomunikacioneve miratojnë rregulloren për përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve të vëllimshme.

3. Vendet për depozitimin dhe asgjësimin e mbetjeve të vëllimshme miratohen nga organet e qeverisjes vendore, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 21 të këtij ligji.

Neni 18

Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore

1. Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore kryhen nëpërmjet djegies në impiante të posaçme.

2. Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Mjedisit miratojnë rregulloren e përpunimit dhe të asgjësimit të mbetjeve spitalore, si dhe kriteret e rregullat për instalimin dhe funksionimin e impianteve të djegies.

Neni 19

Mbetjet ndërkufitare

1. Mbetjet urbane, të krijuara gjatë transportit ndërkufitar (ajror, ujor dhe rrugor), të pasagjerëve, veçohen në pikën kufitare dhe trajtohen si mbeturinat urbane të zonës.

2. Ministri i Mjedisit, Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Transportit dhe Telekomunikacioneve miratojnë udhëzimin për administrimin e mbetjeve në pikat e kalimit kufitar.

Neni 20

Groposja e mbetjeve

1. Groposja e mbetjeve është etapa e fundit, së cilës i nënshtrohen të gjitha mbetjet, objekt i këtij ligji, si dhe hedhurinat që rezultojnë pas trajtimit të tyre.

2. Nuk lejohet të groposen:

mbetjet e lëngëta;

mbetjet eksplozive dhe oksiduese;

mbetjet e përflakshme;

ç) mbetjet spitalore, infektive dhe shpuese;

gomat e përdorura të automjeteve.

Neni 21

Instalimi i impianteve

Përcaktimi i vendit ku instalohen impiantet e përpunimit dhe të asgjësimit të mbetjeve, i nënshtrohet procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis, duke mbajtur parasysh kriteret e mëposhtme:

a) të jetë larg nga vendbanimet, nga rrugët kombëtare dhe zonat me lëvizje të dendur të njerëzve dhe kafshëve;

b) të jetë në formacione gjeologjike, që pengojnë filtrimet e mundshme;

c) të mos jetë në afërsi të burimeve ujore sipërfaqësore, nëntokësore, baseneve, tokave të lagura, lagunave, kënetave, pyjeve, kullotave, zonave me ndjeshmëri të lartë ekologjike dhe zonave të mbrojtura turistike dhe me trashëgimi kulturore;

ç) të jetë larg zonave që mund të përmyten;

d) të lejojë lëvizjen e brendshme të automjeteve dhe të mekanizmave që transportojnë dhe përpunojnë mbetjet.

Neni 22

Rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, fushat ekzistuese të depozitimit të mbetjeve urbane i nënshtrohen administrimit paraparak në drejtim të:

- mbulimit me dhe e ngjeshjes;
- b) hapjes së kanaleve të veçanta për ujërat e shiut, ujërat sipërfaqësore dhe për ekstraktet e mbetjeve dhe grumbullimin e tyre në një basen të izoluar;
- mbrojtjes nga zjarret;
- ç) ndalimit të hyrjes së personave të paaautorizuar;
- d) mbulimit me dhe e gjelbërimit të pjesës së fushës, ku nuk depozitohen më mbetje.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, dampat industriale ekzistuese mirëmbahen dhe rehabilitohen, sipas kërkesave të përcaktuara në këtë ligj për administrimin e mbetjeve industriale.

3. Ministri i Mjedisit dhe Ministri i Industrisë dhe Energjetikës miratojnë udhëzimin për rehabilitimin e dampave, sipas veçorive të mbetjeve që ato mbartin.

KREU IV

KOMITETI I ADMINISTRIMIT TË MBETJEVE TË NGURTA

Neni 23

Komiteti i Administrimit të Mbetjeve të Ngurta

1. Për të bashkërenduar detyrat e ministrive për administrim mjedisor të mbetjeve krijohet Komiteti i Administrimit të Mbetjeve të Ngurta si organizëm ndërmisor në nivel zëvendësministrash. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit të Mjedisit, miraton përbërjen, organizimin dhe funksionimin e tij.

2. Çdo fund viti, Komiteti paraqet për shqyrtim në Këshillin e Ministrave raportin vjetor të gjendjes dhe të administrimit të mbetjeve në shkallë vendi.

Neni 24

Plani kombëtar

Për zbatimin e kërkesave të këtij ligji, Këshilli i Ministrave miraton Planin Kombëtar të Administrimit të Mbetjeve të Ngurta, të propozuar nga Komiteti i Administrimit të Mbetjeve të Ngurta.

KREU V

LEJA MJEDISORE

Neni 25

Leja mjedisore

1. Personat fizikë dhe juridikë që marrin përsipër grumbullimin, transportimin, përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve, pajisen me leje mjedisore përkatëse, duke u përjashtuar nga tarifa e shërbimit për marrjen e lejes.

2. Kur veprimtaritë e mësipërme ushtrohen në shkallë vendi, leja miratohet nga Ministri i Mjedisit. Për veprimtaritë lokale, miratimi bëhet nga agjencitë rajonale të mjedisit në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore.

KREU VI IMPORTIMI, EKSPORTIMI DHE TRANZITIMI I MBETJEVE

Neni 26 **Leja e importit**

Në Republikën e Shqipërisë ndalohet importimi i mbetjeve për ruajtje, depozitim ose asgjësim.

Neni 27 **Eksportimi i mbetjeve**

1. Personat fizikë dhe juridikë, që do të eksportojnë mbetje, pajisen me leje eksportimi të mbetjeve. Ministri i Mjedisit përcakton rregullat e kërimit, të shqyrtimit dhe të miratimit të lejes së eksportimit, si dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për leje.

2. Eksportimi i mbetjeve lejohet me miratimin e autoriteteve përgjegjëse të shtetit ku do të importohet dhe të shteteve, në territoret e të cilave do të tranzitohet mbetja.

3. Në rast se shteti importues ose shtetet, në territoret e të cilave do të tranzitohet mbetja, refuzojnë të pranojnë mbetjen e eksportuar, eksportuesi mbulon vetë shpenzimet për asgjësimin e sigurt të mbetjeve.

Neni 28 **Tranzitimi i mbetjeve**

1. Tranzitimi i mbetjeve në territorin e Republikës së Shqipërisë bëhet me leje të miratuar nga Ministri i Mjedisit, sipas rregullave dhe procedurave të miratuara prej tij dhe Ministri i Transportit dhe Telekomunikacioneve.

2. Tranzitimi i mbetjeve nuk lejohet pa miratimin e autoriteteve përgjegjëse të shtetit importues, shtetit eksportues dhe të shteteve të tjera, në territoret e të cilave do të tranzitohet.

Neni 29 **Shkelja e rregullave të lëvizjes së mbetjeve**

1. Në rast të shkeljes së rregullave të importit, të eksportit dhe të tranzitimit të mbetjeve, autoritetet e doganës dhe ato të policisë kufitare bllokojnë lëvizjen e mbetjeve dhe njoftojnë Ministrinë e Mjedisit dhe Ministrinë e Rendit Publik.

2. Ministria e Mjedisit është autoriteti përgjegjës kombëtar dhe bashkërenduesi i të gjitha marrëveshjeve ndërkombëtare për administrimin mjedisor të mbetjeve, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

KREU VII MONITORIMI I ADMINISTRIMIT TË MBETJEVE

Neni 30 **Detyrimi për monitorim**

1. Monitorimi i mbetjeve është pjesë e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit dhe kryhet sipas kërkesave të tij. Monitorimi i mbetjeve përfshin të gjitha fazat e procesit të administrimit të tyre, sipas këtij ligji dhe realizohet i veçantë për çdo lloj mbetje.

2. Personat fizikë dhe juridikë, veprimtaritë e të cilëve krijojnë mbetje, që trajtohen nga ky ligj, si dhe personat fizikë dhe juridikë të pajisur me leje mjedisi për grumbullimin, transportimin, përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve, monitorojnë kryerjen e këtyre veprimtarive me shpenzimet e veta dhe

publikojnë të dhënat që dalin çdo tre muaj.

3. Ministri i Mjedisit miraton rregulloren e monitorimit të mbetjeve, e cila është e detyrueshme për subjektet e përmendura në pikën 2 të këtij neni.

KREU VIII KONTROLLI

Neni 31

1. Ndaj veprimtarisë së zotëruesve të mbetjeve ushtrojnë kontrolle Inspektorati i Mjedisit, organi që ka licencuar veprimtarinë, Inspektorati Sanitar Shtetëror dhe inspektorati bashkiak.

2. Inspektorati bashkiak dhe Inspektorati Sanitar Shtetëror kontrollojnë zbatimin e rregullave dhe të kërkesave për krijimin, grumbullimin, ruajtjen, transportimin, përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve urbane, të mbetjeve të ndërtimit dhe të mbetjeve të vëllimshme.

3. Inspektorati i Mjedisit kontrollon zbatimin e rregullave dhe të kërkesave për trajtimin dhe administrimin e mbetjeve dhe kushtet e vendosura në lejen mjedisore për:

- a) krijimin, grumbullimin, ruajtjen, lëvizjen dhe përpunimin e mbetjeve të tjera nga ato të përmendura në pikën 2 të këtij neni;
- b) funksionimin e impianteve dhe të instalimeve të përpunimit dhe të asgjësimit të mbetjeve;
- c) transportin dhe lëvizjen e mbetjeve brenda proceseve të administrimit të tyre;
- ç) kryerjen e monitorimit të mbetjeve nga zotëruesit e tyre;
- d) mbajtjen e regjistrave të veçantë për mbetjet;
- dh) zbatimin e programeve vetjake të masave teknike, teknologjike e organizative.

KREU IX SANKSIONET

Neni 32

1. Kur shkeljet e dispozitave të këtij ligji përbëjnë vepër penale, Inspektorati i Mjedisit bën kallëzimin për ndjekje penale.

2. Shkeljet e mëposhtme të dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e mjedisit:

- a) ushtrimi pa leje mjedisore i veprimtarive, duke shkelur kërkesat e nenit 25 të këtij ligji;
- b) shkelja e kërkesave dhe kushteve të vendosura në lejen mjedisore për administrimin e mbetjeve;
- c) mosrespektimi i detyrimeve gjatë vënies në punë të impianteve dhe të instalimeve;
- ç) braktisja, shkarkimi ose hedhja e mbetjeve jashtë vendeve të përcaktuara;
- d) përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve jashtë vendeve të përcaktuara nga organet përkatëse;
- dh) braktisja e instalimeve, venddepozitimeve dhe impianteve të përpunimit e asgjësimit të mbetjeve;
- e) përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve me teknika dhe teknologji të papërshtashme dhe të pamiratuara, si dhe djegia në natyrë dhe lejimi i vetëdjegies së tyre;
- ë) importimi i mbetjeve dhe hedhurinave, në kundërshtim me kërkesat e nenit 26 të këtij ligji;
- f) mosbërja e rregullimeve për të sjellë mjedisin në gjendjen e mëparshme;
- g) moskryerja e monitorimit në të gjitha etapat e procesit të administrimit të mbetjeve;
- gj) mosdhënia në afatet e kërkuara e të dhënave dhe njoftimeve për gjendjen dhe ndotjen e mjedisit gjatë të gjitha etapave të procesit të administrimit të mbetjeve dhe mospublikimi i tyre, i shoqëruar edhe me sqarimin e masave për mbrojtjen e popullsisë.

Neni 33
Masat e gjobave

1. Për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenin 32, jepen dënime me gjobë:
për shkronjat “a”, “b” dhe “c” nga 300 000 deri në 500 000 lekë;
b) për shkronjat “ç”, “d”, “dh”, “e” dhe “ë” nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë;
për shkronjat “f”, “g” dhe “gj” nga 100 000 deri në 300 000 lekë.
2. Krahës dënimit me gjobë, Inspektorati i Mjedisit mund të vendosë mbylljen e përkohshme ose të përhershme të veprimtarisë, në varësi nga ndotja dhe dëmtimi i shkaktuar.

Neni 34
Ankimi

1. Kundër vendimit të Inspektoratit të Mjedisit mund të bëhet ankim te Ministri i Mjedisit brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit. Ministri i Mjedisit duhet t’i përgjigjet ankimit brenda 30 ditëve.
2. Kundër vendimit të Ministrit të Mjedisit ose kur ky i fundit nuk përgjigjet brenda afatit 30-ditor, mund të bëhet ankim, brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, në gjykatën e rrethit ku është bërë kundërvajtja.

Neni 35
Akte nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë akte nënligjore në zbatim të nenit 3 pika 3, nenit 23 pika 1 dhe nenit 24 të këtij ligji.
2. Ngarkohet Ministri i Mjedisit dhe ministrat përkatës të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të nenit 11 pika 2, nenit 12 pika 2, nenit 13 pika 2, nenit 14 pika 2, nenit 16 pika 2, nenit 17 pika 2, nenit 18 pika 2, nenit 19 pika 2, nenit 22 pika 3, nenit 27 pika 3 dhe nenit 29 pika 1 të këtij ligji.

Neni 36
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3742, datë 19.3.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu.**

V E N D I M
Nr.173, datë 7.3.2003

**PËR EMËRIMIN, LIRIMIN OSE SHKARKIMIN NGA DETYRA TË DREJTUESVE TË
INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, KRYEMINISTRIT OSE
TË MINISTRIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Shtetit pranë Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Drejtuesit e institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit

emërohen, lirohen ose shkarkohen nga detyra, përkatësisht nga Kryeministri ose ministri përkatës, në rast se dispozita të tjera, të veçanta, ligjore dhe nënligjore, nuk parashikojnë ndryshe.

2. Emërimi i drejtuesve të institucioneve të treguara në pikën 1 bëhet sipas kërkesave dhe procedurave të mëposhtme:

- Kryeministri ose ministri përkatës urdhërojnë, të paktën 15 ditë përpara datës së emërimit, shpalljen në media të vendit të lirë.

- Kandidatët e paraqitur, krahas kërkesave të përgjithëshme për t'u punësuar në shërbimin civil, sipas nenit 12 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", duhet të plotësojnë edhe kërkesat e veçanta, të cilat jepen në shpalljen në media të vendit të lirë.

- Kryeministri ose ministri përkatës përzgjedh dhe emëron njërin nga kandidaturat e paraqitura që plotëson kërkesat e mësipërme.

3. Lirimi ose shkarkimi i drejtuesve të institucioneve të treguara në pikën 1, duhet të jetë i motivuar, pasi të jenë dëgjuar edhe pretendimet e personit.

4. Kur në dispozita të tjera, të veçanta, ligjore dhe nënligjore, është përcaktuar organi i emërtesës për drejtuesit e institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit, por nuk përcaktohen kërkesat dhe procedurat për emërimin, lirin ose shkarkimin e tyre, në këto raste zbatohen pikat 2 dhe 3, të këtij vendimi.

5. Kur në dispozita të veçanta, ligjore dhe nënligjore, përcaktohet se drejtuesi i institucionit, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit, emërohet, lirohet ose shkarkohet nga Këshilli i Ministrave, por që nuk janë parashikuar kërkesat dhe procedurat për emërimin, lirin ose shkarkimin e tyre, zbatohen kërkesat dhe procedurat e mëposhtme:

- Procedura e emërimit, lirit ose shkarkimit fillon nga Kryeministri ose ministri përkatës, sipas varësisë së institucionit.

- Kryeministri ose ministri përkatës urdhërojnë, të paktën 15 ditë përpara datës së emërimit, shpalljen në media të vendit të lirë.

- Kandidatët e paraqitur duhet të përmbushin, krahas kërkesave të përgjithëshme për t'u punësuar në shërbimin civil, sipas nenit 12 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", edhe kërkesat e veçanta, të cilat jepen në shpalljen në media të vendit të lirë.

- Kryeministri ose ministri përkatës i propozojnë Këshillit të Ministrave jo më shumë se tri nga kandidaturat e paraqitura, që plotësojnë kërkesat e mësipërme.

- Këshilli i Ministrave përzgjedh dhe vendos, me shumicën e anëtarëve, emërimin e njërit prej kandidatëve.

- Propozimi i lirit ose shkarkimit duhet të jetë i motivuar, pasi të jenë dëgjuar pretendimet e personit.

- Këshilli i Ministrave, në mbledhjen e vet të parë, merr vendimin për propozimin e lirit ose të shkarkimit.

6. Vendimi nr.469, datë 14.8.1995, i Këshillit të Ministrave "Për kompetencat për emërimin dhe largimin nga detyra të drejtorëve të drejtorive në ministri dhe institucione të tjera qendrore dhe ndryshimet në strukturat e tyre", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbardimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

U dorëzua për shtyp më 21.3.2003
Doli nga shtypi më 21.3.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë